

RAPORT I VLERSIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

OBJEKTI

**"SISTEMIM ASFALTIM RRUGËT KOSMAÇ 2026,
VAU DEJËS "**

LENI-ING SHPK

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	3
2.	PËRSHKRIM I PROJEKTIT.....	4
2.1	Qëllimi i projektit	4
2.2	Vendodhja e objektit.....	4
2.3	Të dhëna teknike të objektit	4
3.	PËRSHKRIM I KUADRIT LIGJOR	11
3.1	Të përgjithshme	11
3.2	Kuadri ligjor	14
3.3	Kuadri ligjor ndërkombëtar për VNM-në	16
4.	PËRSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUES.....	16
4.1	Të dhëna të përgjithshme	16
4.2	Gjeologjia	17
4.3	Gjeomorfologjia	18
4.4	Tektonika.....	19
4.5	Flora	20
4.6	Fauna.....	21
4.7	Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës.....	22
4.8	Kushtet Hidrogjeologjike.....	22
4.9	Klima	23
4.10	Regjimi i rrezatimit.....	24
4.11	Temperatura e ajrit	25
4.12	Lagështira relative mesatare e ajrit në %.....	26
4.13	Reshjet atmosferike	27
4.14	Era	29
4.15	Ngjarjet e pazakonta klimaterike	29
5.	VLERËSIME TË NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	30
5.1	Ndikimet ne terren dhe peisazh.....	30
5.2	Dherat dhe Ri-shfrytezimi i materialeve të gërmuara	31
5.3	Ndikimi në nivelin e zhurmave.....	31
5.4	Ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	31
5.5	Emëtimet në ajër	32

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME KOSMAC”

5.6	Ndikimi në nivelin e zhurmës.....	32
5.7	Mbetjet	33
6.	MASAT KRYESORE LEHTËSUESE	34
7.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	36

1. HYRJE

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) është një prej instrumentave parandalues dhe minimizues të ndikimit mjedisor dhe për projektin specifik, hartohet duke u bazuar në zhvillimin strategjik të zonës. Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar në përdorimin e tokës, efektet lidhur me ndikimet në floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere në atmosfere, shkarkimet në toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukurës dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit.

Në këtë raport do të trajtojmë zhvillimin e projektit të objekti: **“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDASHME MELGUSHE”**, zona ku do të zhvillohet projekti ndodhet në, ndodhet në Bashkinë Vau Dejes, Qarku Shkoder. Hartohet me kërkesë të investitorit të këtij projekti **Bashkia Vau Dejes** dhe nëpërmjet **subjektit LENI-ING.shpk**, me përfaqësues ligjor **Z. Nikoll PALUCA**.

Ky raport do të japë një vlerësim të përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve që do të ketë në komponentët përbërës të mjedisit ndërtimi I kësaj rruge në Bashkinë Vau Dejes, duke parashikuar masa dhe veprime për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis. Gjithashtu një synim tjetër është të përcaktojë dhe rekomandojë masat teknike organizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit. Gjatë kryerjes së punimeve ndërtuesi do të marrë të gjitha masat për zbatimin me përpikmëri të projektit të hartuar, që ai të sigurojë një zhvillim normal të punimeve pa dëmtuar mjedisin.

2. PËRSHKRIM I PROJEKTIT


2.1 Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është ndërtimi i objektit: **“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME MELGUSHE”**, ndodhet në Bashkinë Vau Dejes, Qarku Shkoder. Ky rikonstruksion konsiston në ndërhyrjen në rrugët lidhëse të disa grupeve banesash private, me gjatësi 4640 m që lidhin disa shtëpi me rrugën kryesore. Sheshi i ndërtimit është vetë rruga ekzistuese urbane. Gjendja ekzistuese e rrugës paraqitet e amortizuar, ne bazament të dobët dhe me gropa, gjë që vështirson kalimin. Shtresat e rrugës janë të dëmtuara dhe trotualet mungojnë plotësisht.

2.2 Vendodhja e objektit

Sheshi I ndërtimit të objekti të propozuar **“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME MELGUSHE”** ndodhet në ndodhet në Bashkinë Vau Dejes, Qarku Shkoder. Gjatesia e rruges eshte rreth 4640 m, kurse gjeresia e trupit te rruges ekzistuese varion nga 4.5 - 5 m, segmenti që është përfshirë në këtë projekt. Rruga ekzistuese kalon në zonë te banuar.

Plani i Përgjithshëm i vendndodhjes se rrugës



2.3 Të dhëna teknike të objektit

Projekti është hartuar duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat që ka zhvilluesi për të krijuar një objekt të ri. Projekti plotëson të gjitha kondicionet në përputhje me rregulloren në fuqi, është

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDASHME KOSMAC”

realizua duke respektuar të gjitha standartet për rrugë të ngjashme. Grupi I projektimit të këtij objekti ka ndjekur hapat e nevojshëm të studimit e investigimit për realizimin e projekt zbatimit, analizimit dhe zgjedhjes paraprake të kësaj vepre. Zgjedhja e këtij variant I refërohet kushteve topografike, kushteve të trafikut në këtë aks të cilat janë të moderuara dhe gjithashtu kërkesave të autoriteti kontraktor.




CEKAJ



GAJUPI




HASANI



HAXHANI

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME KOSMAC”




IDRIZI (segmenti 1)



IDRIZI (segmenti 2)



JAKU



PERAJ

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME KOSMAC”



RAMADANI



SEFERI



SULEJMANI



TAHIRI

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME KOSMAC”



THAQI



VIJA E DRINIT



VIJA E VJETER




VIJA E EVJETER

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME KOSMAC”

Ky profil aplikohet në segmentet që përgjithësisht paraqiten në gjendje të mirë teknike. Megjithatë, në rastet ku konstatohet formacion gjeologjik i dobët ose kërkohet arritja e niveletës projektuale, parashikohet ndërhyrje me shtresë zhavorrit në mënyrë të pjesshme.

Percaktimi i segmenteve konkrete ku do të aplikohet shtresa e zhavorrit do të bëhet gjatë fazës së zbatimit, nëpërmjet monitorimit të përballë nga Investitori, Mbroqëyesi dhe Subjekti zbatues.



Per realizimin e projektit(e investimit te parashikuar) nuk do të bëhën shpronësime te pjesshme ne dy ane te rruges, do të respektohet gjerësia ekzistuese, rruga me gjatësi totale 4640 m. Gjerësia e pjesës së asfaltuar te rruges është ka dy profile tip (3.2 m asfalt plus 2x0.65 m bankina). Ne kendveshtrimin e gjërësise se trupit te rruges, te dy profilet jane te njejte. Ne kendveshtrimin e paktetave te shtresave është gjykuar qe t ek profili tip 2 te mos vendoset shtresa e zhavorrit. Profili tip 2 është i vlefshem per ato pjese te rruges ekzistuese ku gjendja e shtresave paraqitet e mire. Ky propozim per kuroren e asfaltuar te rruges ruan parametra te kenaqshem shfrytëzimi, kosto te ulet ndertimi e mirembajtjeje per rruge te kesaj kategorie ne zona te tilla kodrinore e fushore. Thëksojme se ky standart është aplikuar edhe ne rruge te tjera.

Planimetria

Ne planimetrine e rruges paraqiten parametrat gjeometrike te cilet ne funksion te kategorise se rruges, terrenit dhe shpejtesise llogaritesen percaktojne rrezet minimale ne kthesa, distancën e shikimit dhe parakalimit duke ofruar keshtu siguri e komoditet per perdoruesin e rruges.

Seksioni terthor tip

Projektuesi i është permbajtur variantit te propozuar paraprakisht pra ka pranuar kuroren e asfaltuar ne dy profile tip (3.2 m asfalt plus 2x0.65 m bankina). Ne kendveshtrimin e gjërësise se trupit te rruges, te dy profilet jane te njejte. Ne kendveshtrimin e paktetave te shtresave është gjykuar qe t ek profili tip 2 te mos vendoset shtresa e zhavorrit. Profili tip 2 është i vlefshem per ato pjese te rruges ekzistuese ku gjendja e shtresave paraqitet e mire. Gjatë hartimit te projekt zbatimit seksioni tërthor tip realizon një gjerësi kalimi për këmbimin e dy mjeteve njëkohësisht me shpejtësi të kufizuar.

Per këtë klasifikim të rrugës shpejtësia e projektuar varion nga 30 -50km/ore .

Pjersia gjatësore e rruges

Pjerresia mesatare e realizuar ne projekt per rruget e kesaj rruge eshte afersisht 4%.

Pjeresia terthore e rruges

Profili terthor i rruges eshte me 1(nje) pjerrësi 2.5%.

3. PËRSHKRIM I KUADRIT LIGJOR

3.1 Të përgjithshme

VNM është një proces sistematik per te percaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një shtate normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së. Kujdes i veçantë i kushtohet praktikave të VNM për të parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative në mjedis dhe shëndet të veprimeve te ndërmarra. Qëllimi i VNM është të:

- Të japë informacion për vendim-marrësit për pasojat mjedisore të studimet e propozuara;
- Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm me mjedisin duke identifikuar masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis.

Reduktimi i ndikimeve në mjedis arrihet nëse një zhvillim bëhet i qëndrueshëm me mjedisin. Këto ndikime janë mjaft komplekse, më të mëdha në shkallë dhe për më tepër shtrijnë pasojat e tyre më shumë se 10 vjet më parë ku u fut koncepti i VNM-së në vendin tonë. Si rezultat, VNM është kthyer në një dokument kyç për vendimarrjen për miratimin e një zhvillimi të propozuar.

Në aspektin ndërkombëtar, roli i VNM është njohur ne Principin e 17 të Deklaratës për Mjedisin dhe Zhvillimin. VNM, si një instrument kombëtar duhet të aplikohet për aktivitetet e propozuara të cilat pritet që të kenë ndikim negativ në mjedis dhe janë subjekt i një vendimmarrje të një Autoriteti Kombëtar.

Qëllimi dhe objektivat e VNM mund të ndahen në dy kategori. Qëllimi i parë, drejtpërdrejtë, është të informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale në mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit të propozuar. Qëllimi përfundimtar afatgjatë i VNM është të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që propozimet e projektit nuk minojnë burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mirëqënien, stilin e jetës dhe jetesën e komunitet si dhe të njerëzeve që lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurtër dhe të drejtpërdrejtë të VNM:

- Përmirësim nga pikëpamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efikasitet;
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit apo propozimit;

- Lehtëson informimin e vendimmarrësit, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit të propozuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit ;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentët përbërës të ekosistemeve;
- Përmirëson aspektet sociale të projektit

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë kërkohet: “Mirëmbajtje e një mjedisi tepër të shëndetshëm dhe ekologjik për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm”. Kjo por edhe opinionin e gjithë shoqërisë i shprehur nëpërmejt ligjeve të tjerë, detyron marrjen e masave immediate për rehabilitimin e mjedisit të degraduar gjatë “epokës së industrializimit socialist” dhe ruajtjen e tij nga aktivitetet e sotme prodhuese, përpunuese apo ndërtuese që gjithashtu mund të shkaktojnë dëmtime të mjedisit. Legjislacioni në lidhje me ruajtjen e mjedisit është në përputhje me normativat Europiane të mbrojtjes së tij ndonëse cilësia mjedisore është ende në parametra mjaft të ulët, kjo edhe në krahasim me vendet e tjera Europiane.

Ligji i parë për mbrojtjen mjedisore daton në vitin 1993 dhe shprehet se: “Të gjitha veprimtaritë e personave fizike dhe ligjore, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të nënshtrohen vlerësimeve mjedisore”. Më tej, Ligji Nr. 8934, mbi mbrojtjen mjedisore përcakton se : “Mbrojtja e mjedisit është detyrim i” të gjithë shtetasve dhe individëve me veprimtari në Shqipëri”. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë potencial ndotës në mjedis.

Sipas Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 Për mbrojtjen e mjedisit, me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

- Parimi "Ndotësi pagan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e përbërësve të mjedisit klasifikohet në:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Legjislacioni i VNM

Sa më sipër, ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është mbështetur në legjislacionin mjedisor si më poshtë dhe ka për qëllim që të identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti në mjedis.

Kuadri ligjor për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri Ligji Për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligji për Vleresimin e Ndikimit në Mjedis. Këto ligje së fundmi janë përafuar plotësisht me ligjet e Bashkimit Europian për mbrojtjen e mjedisit dhe Vleresimin e Ndikimit në Mjedis.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit në Mjedis (VNM-së) përcakton tipin dhe shkallën e projekteve apo veprimtarive që kërkojnë VNM para implementimit.

Kategoritë e VNM-ve janë:

- VNM-ë paraprake. Ky vlen për projekte që mund të kenë impakte potenciale më të vegjël në përmasa që sërish kërkojnë një vleresim profesional të impakteve të tyre. Këto përfshijnë projekte që janë listuar në Shojcën 2 të Ligjit për VNM-në dhe ndryshime apo rehabilitime të projekteve të listuar në Shtojcën 1
- VNM- ë e Thelluar. Ky vlen për projekte me impakte potencialisht të konsiderueshme, siç figurojnë në listën e Shojcës1 të Ligjit, ato projekte të listuara në Shtojcën 2 për të cilët Agjencia Kombetare e Mjedisit mendon se do të kenë një impakt të konsiderueshëm mbi mjedisin (bazuar në informacionin e siguruar nga propozuesi në kohën e aplikimit) dhe veprimtaritë që janë për tu implementuar në zonat e mbrojtura apo zona bregdetare të Republikës së Shqipërisë.

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër ligjet më specifike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektin në vlerësim, mund të përmendim: Në ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet në kapitullin V (VNM) neni 25 se: Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit. Në Ligjin Nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” në kreun II, neni 7 për “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” thuhet: Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-se për projektet e shtojcës I.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin indentifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit në mjedisin ku do të zbatohet, si dhe përcaktimi i masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis që në fazën fillestare të tij.

3.2 Kuadri ligjor

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore të cilat kanë ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-të dhe zhvillimeve të fundit në fushën e ndërtimit dhe industrisë. Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) i kushtetutës shkruhet se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: Neni d): një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Sipas Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Mjedisit është autoriteti përgjegjës për rishikimin e dokumentit VNM të përgatitur nga ekspertët e licensuar prej Ministrisë së mjedisit. Përvec Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi edhe Ligjin Nr. 10440 Datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”. Ky ligj është zhvilluar dhe bazuar në Direktivat e EU dhe praktikat ndërkombëtare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Ndër ligjet e tjera të legjislacionit kombëtar në lidhje me aktivitetin përfshihen ligjet dhe vkm si mëposhtë:

- Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”
- Ligj Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”

- Ligji Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligj Nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Ligji nr.9587, datë 08.09.2002 “Për mbrojtjen e biodiversitetit ”
- Ligji Nr. 111/2012“Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”
- Vendim Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të Mjedisit”
- Vendim Nr.824, datë 11.12.2003, “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”.
- Vendimi Nr.247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.
- Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për menaxhimin e zhurmave”
- Vendim Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”
- Vendim Nr. 435, datë 12.9.2002 “ Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”.
- Vendim Nr. 313, datë 09.05.2012 “Për rregulloren e mbrojtjes së publikut nga shkarkimet në mjedis”.
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 994, datë 02.07.2008 “Për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje“.
- Vendimi nr.805, datë 04.12.2003 “Për miratimin e listës së veprimtarive, që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkojnë Leje Mjedisore“
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse”
- Vendim Nr. 538 datë 26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”
- Vendim Nr. 16, datë 14.01.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”
- Vendim Nr. 13, datë 04.01.2013 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
- Udhëzim Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në Republikën e Shqipërisë
- Udhëzim Nr. 1037-1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore”
- Udhëzim Nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen ministria e mjedisit për procesin e VNM-së”

3.3 Kuadri ligjor ndërkombëtar për VNM-në

Direktiva e BE-së

Qëllimi i Direktivës 2003/35/EC mbetet që të kontribuojë në zbatimin e detyrave që rrjedhin nga konventa e Arhus.

Direktiva e Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC, e cila:

- përcakton e termit “publik” dhe “palët e interesuara”;
- mundësinë e një lloji tjetër vlerësimi në rrethanat e vecanta për përjashtimin e projekteve të vecanta nga procedura e VNM dhe nga informacion publik përkatës;
- procedura e burimit për palët e treta.

Direktiva e Këshillit me nr. 97/11/EC mundëson se klienti pajiset me informacionin e duhur të listuar si më poshtë:

- një përshkrim i përbërësve mjedisorë që kanë një ndikim të rëndësishëm në zbatimin e këtij projekti, me referencë të vecantë për popullsinë, flora dhe fauna, ujrat nëntokësorë, ajri, faktoret klimaterikë, gjeologjia/terreni, duke përfshirë trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike, etj;
- një përshkrim i karakteristikave fizike të projektit, me kërkesat e shfrytëzimit të tokës gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe ndërhyrjeve dhe karakteristikat paresore të proceseve të prodhimit;
- një vlerësim mbi llojin dhe sasinë e shkarkimeve të llogaritura në vend (ndotjen e ujit, ajrit dhe tokës, zhurmës, lekundjet, ndricimin dhe nxehtësinë, rrezatimin, etj) duke rezultuar nga veprimtarite e projektit të propozuar;
- përshkrim përmbledhës të alternativave kryesore të vlerësuara nga Investitori, me tregues të arsyetimeve kryesore të zgjidhjeve, sipas profilit të impaktit mjedisor.

4. PËRSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUES

4.1 Të dhëna të përgjithshme

Bashkia e Vau-Dejës bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distancë 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana dhe 81 km nga Aeroporti i Rinasit. Ajo ka një sipërfaqe prej 468 km² ku 10 465 ha janë tokë bujqesore. Bashkia e Vau-Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Shkodrës, në lindje me Bashkinë Fushë-Arrëz ndërsa në jug me Bashkitë Pukë dhe Lezhë.

Ajo përbëhet nga 6 njësi administrative me një popullsi prej 50 130 banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë.

Bashkia e re ka nën administrimin e saj qytetin e Vaut të Dejës, 47 fshatra dhe zgjerohet në 5 njësi administrative.

Aktiviteti kryesor ekonomik është bazuar në bujqësi dhe blegtori, biznesi i vogel dhe shërbimet. Vau-Dejës gjithashtu ka një zhvillim në sektorin e prodhimit të energjisë, me hidrocentralin e Vaut të Dejës, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2. Në Bashkinë e Vau të Dejës ndodhet dhe Landfilli rajonal I Bushatit, si pikë grumbulimi dhe përpunimi i mbetjeve për rajonin Shkodër-Lezhë.

E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, që perben një pasuri natyrore të vlerfshme për zonën, ku dominon liqeni i Vaut të Dejës, lumi Drin dhe lumi Gjadër.

Zhvillimi i turizmit natyror gjithashtu është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vaut të Dejës gjenden kështjellat “Shurdhah”, “Sarda”, “Dalmicë”, “Danja”, “Kalaja e Vigut”, Qendra Muzeale “Ndre Mjeda”, objektet fetare, kisha e “Shen Markut”, “Shen Kollit”, e “Shen Rrokut” si dhe xhamia e Bushatit, xhamia e Kosmacit dhe ajo e Melgushes, ndër më të vjetrat në Ballkan të cilat ende sot mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Liqeni i Vaut të Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau i Dejës deri në Koman.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrat Civil	Sipërfaqja KM ²
Shkodër	Qyteti Vau-Dejës	Vau-Dejës	Qytetet Vau Dejës, Fshatrat; Mjeda, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe	30,438	50,042	468,00
		Bushat	Fshatrat; Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten			
		Vig-Mnele	Fshatrat; Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig			
		Hajmel	Fshatrat; Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë			
		Temal	Fshatrat; Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Klogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë			
		Shllak	Fshatrat; Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj			

4.2 Gjeologjia

Gjeologjia Në territorin Bashkisë Vau-Dejës përfshihen segmente të zonave tektonike Krasta-Cukali, Kruja, Mirdite. Territori lindor dhe verior i Bashkisë Vau-Dejës Territori karakterizohet nga shkëmbinj të formacioneve karstike të Krast Cukalit si dhe shkëmbinj të magmatike të zonës Mirditë. Shkëmbinj të mesatarisht të fortë, përfaqësohen nga flishi i zonës së Krastës dhe më pak nga rreshpe argjilasilicore të serisë efuzivo-sedimentare të zonës Mirditë. Dherat e këtyre zonave janë pa lidhje kohezionale, ndërkohe që zhavorret e përroit të Gomsiqes karakterizohen nga ndërthurje të vogla dhe shume pak argjila. Proceset gjeodinamike të kësaj zone karakterizohen nga një tektonike e tipit mbihypje dhe përfaqësohet nga ndërthurja e zonës Mirdita dhe Krasta-Cukal. Tektonika shkëputëse është pak e zhvilluar. Rrëshqitjet janë karakteristike për formacionet flishore. Rrëshqitje masive janë evidentuar në aksi të rrugës automobilistike Vau-Dejës-Koman sidomos në zonën e Karmës. Erozioni është i formës sipërfaqësore. Erozioni që zhvillohet në zonën

e Gomsiqes ka bërë që liqeni i Vaut të Dejës të zvogëlojë sipërfaqen e tij nga prurjet e përrrenjve. Rrëzimi i gurëve si fenomen është vënë re në afërsi të urës së Gomsiqes dhe të shkollës së Karmës. Karsti shprehet në formën e fushës karstike në zonën e Shllakut. Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, në sipërfaqe shfaqen shkëmbinjtë rrënjësorë dhe dhera të kuaternarit të tipit mbulesor por që kanë trashësi të tillë që nuk mund të neglizhohen gjatë kryerjes së ndërtimeve në fushëpërhapjen e tyre. Sipas Konomi N. [Konomi N., 1998], kemi adoptuar një klasifikim gjeologjik – litologjik – inxhinierik të shkëmbinjve dhe dherave.

Në këtë klasifikim shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

- shkëmbinj të fortë;
- shkëmbinj mesatare;
- shkëmbinj të butë.

Kriteri i ndarjes së tyre është rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh). Ndërsa dherat janë klasifikuar në tre grupe:

- dhera pa lidhje kohezionale
- dhera me lidhje kohezionale
- dhera me veti të veçanta

Kriteret e ndarjes së dherave, janë: kohezioni (c), (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse) dhe këndi i fërkimit të brendshëm (ϕ).

4.3 Gjeomorfologjia

Bashkia e re Vau-Dejës ndodhet në Qarkun e Shkodrës dhe shtrihet në pjesën veriore të vendit. Qendra më e madhe e afërt urbane është qyteti i Shkodrës, vetëm 20 km larg; ndërsa largësia nga Tirana, 9 kryeqyteti i vendit është 92 km. Bashkia kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e bashkisë është qyteti i Vaut të Dejës. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 468 km². Densiteti i popullsisë llogaritet të jetë 35.1 banorë për km² në bazë të të dhënave të Censurit 2011. Njësia administrative e Temalit ka sipërfaqen më të madhe të territorit ndërsa Hajmeli shtrihet në vetëm 31 km², duke përfaqësuar njësinë administrative me sipërfaqe më të vogël të bashkisë. Kufiri territorial i bashkisë Vau Dejës, i referuar në këtë dokument dhe në gjithë materialin grafik, është ai i miratuar Ligjin nr. 115/2014, dt. 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” Territori i Bashkisë shtrihet pjesërisht në zonë kodrinore malore në Lindje dhe pjesërisht në zonën perëndimore fushore. Një pjesë e territorit të Bashkisë përbëhet edhe nga liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës. Pjesa më e zhvilluar urbane, në mënyrë të natyrshme, është e pozicionuar përgjatë zonës fushore në perëndim. Për shkak të pozicionit gjeografik specifik të Bashkisë si dhe kalimi i rrugës kombëtar Shkodër Pukë mospërmes territorit të saj ka ndikuar në një konfiguracion urban të veçantë. Ajo që të bie menjëherë në sy është pozicionimi jo i favorshëm i qendrës më të madhe, pra i qytetit të Vaut të Dejës, në një largësi më të madhe me Shkodrën se fshatrat e tjerë të saj si Shëllqet dhe Mjeda. Pjesa më e madhe e zonave urbane shtrihen në zonat fushore dhe aksi rrugor kryesor kombëtar përshkon përkrah zonat më të dendura urbane të Bashkisë. Nga pikëpamja e aksesit fshatrat në zonën

fushore janë më të privileguara se sa qyteti i Vaut të Dejës, duke bërë që të ofrojnë më shumë hapësira dhe mundësi për investime.

4.4 Tektonika

Rajoni i qarkut të Shkodrës bën pjesë në brezin e rrudhosur “Alpin Mesdhetar” në harkun Dinarido - Albanido – Helenik, pjesë e segmentit perëndimor të Mesdheut lindor.

Zonat e nënzonat që veçohen në këtë rajon i përgjigjen mikrobllloqeve të ndryshme :

a) Pjesë lindore të pllakës së Adrias (Apulia).

b) Pjesë perëndimore të mikrokontinentit Korab – Pelagonian.

Përgjithësisht, zonat tektonike ndahen nga njëra-tjetra me kontakte tektonike madhore terciare.


Në rajonin tonë veçohen dy grupime themelore të Albanideve:

ALBANIDET E JASHTME

Karakterizohen nga formacione me seri të vijueshme nga Triasiku deri në nivele të ndryshme të Terciarit. Në Albanidet e Jashtme në rajonin tonë përfshihen zonat e jashtme lindore si; n/z Krasta dhe Njësia e Ostrenit.

ALBANIDET E BRENDASHME

Karakterizohen nga prania e formacioneve ofiolitikë jurasike dhe triasike – liasike dhe formacione kontinentale të përfshira bashkërisht në tektonogjeneza të fuqishme përveçse gjatë Terciarit edhe gjatë Jurasikut të mesëm – të vonshëm dhe Kretakut, të shoqëruara nga deformacione e metamorfizëm intensiv, si dhe shpëlarje nënujore të fuqishme, transgresionë dhe mospërputhje strukturore.



Harta e Rrezikut Gjeologjik të sheshit të ndërtimit (shkalla 1:100.000).

4.5 Flora

Nga pikpamja floristike kjo hapësirë bën pjesë në zonën e shkurreve dhe dushqeve mesdhetare e cila shtrihet nga niveli i detit dhe deri në lartësinë më të madhe të saj. Këtu vegjetojnë shumë lloje të vendit tonë që përveç vlerave prodhuese kanë dhe vlera mbrojtëse, rekreative e turistike. Hapësira ka florë me një gamë të gjerë llojesh, madje shumë lloje kanë edhe vlera të rëndësishme mjekësore, industriale, ushqimore dhe dekorative, duke mbartur kështu edhe vlera ekonomike. Bimësia natyrore, arealet më të përhapura siç e theksuam më sipër i ka në territoret kodrinore dhe në brigjet e lumenjve. Mbulesa bimore përbëhet nga shkurre mesdhetare të përfaqësuar nga makja dhe shiblaku, pyjet e dushkut dhe pyjet e pishave të futura artificialisht.

Shkurret mesdhetare – areali me makje shtrihet në formën e një brezi të plotë në të gjithë anën perëndimore e jugore të parkut . Lloje të makjes përmendim xina, marja, mërsina, ilqja, shqopa etj. Mareja (*Arbutus unedo*) është shoqëruar dhe me bimësi tjetër.

Shqopa (*Erica arborea*) gjendet në këto zone si bime e rendeishme dhe rrënjët e kësaj bime janë shumë të kërkuar në tregun vendas dhe të huaj.

Gjëneshtra (*Spartium junceum*) gjendet kudo në territoret kodrinore, përdoret nga banorët vendas për punimin e shportave dhe koshave për nevojat e tyre në bujqësi. Këto punime artizanale me gjëneshtra vitet e fundit po kërkojnë nga të huajt që vlerësojnë punën e dorës.

Dëllinja (*Juniperus oxycedrus*) me përhapje të zakonshme, frutat e saj janë me vlera ekonomike pasi kanë efekte shëruese për sëmundje të ndryshme dhe mund të përdoren dhe për prodhimin e rakisë.

Dafina e egër (*Laurus nobilis*) gjendet në kodrat më të larta të kësaj zone dhe ka vlera mjekësore. Shkurret gjetherënëse përfaqësohen nga bungbuta në trajtë shkurreje, shkoza e zezë të shoqëruara nga frashëri i bardhë në disa areale gjendet dhe shega e egër.

Pyjet e pishave - përfaqësohen kryesisht nga blloqe të shumta përgjatë bregdetit dhe lagunes Pas dëmtimit në vitet e para të tranzicionit ky pyll sot ruhet në gjendje të mirë si një pasuri e çmuar për banorët e zonës.

Për t’u përmendur në bimësinë drusore është dhe prania e biotopeve të mirëfillta si shelgji shtet, vërrinjtë, plepat, dhe vidhat buzë lumenjve bazeneve ujore, përrenjve, kanaleve vaditë se, burimeve e rezervuareve të ujit..

Mbulesa bimore dhe në veçanti grumbujt pyjor përbëjnë një potencial natyror të rëndësishëm për një zhvillim të qëndrueshëm të hapësirës në studim.

Vitet e fundit pylli po rigjenerohet duke dhënë premiset e një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë pyjore dhe një mbështetje për turizmin e zonës (ky pyll mund të afrojë turizëm të gjelbër, turizëm aventurier, turizëm për piknik, turizëm për gjueti etj).

4.6 Fauna

Sipas studimeve dhe monitorimeve të institucioneve të ndryshme shkencore dhe akademike, për sa u përket shpendëve, mund të thuhet se këta përbëjnë një pjesë të konsiderueshme me vlera për llojet e ekosisteme të cilat takohen brenda këtij territori. Në ujërat e ekosistemeve ujore (lumenjve dhe liqeneve) kemi një shumëllojshmëri të popullatave të peshqve ku si më me vlera mund evidentohen këto lloje kryesore: Krapë (*Cyprinus carpio*), Ngjala (*Anguilla anguilla*), Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*). Në llojet që përmendëm më sipër, duhet të theksojmë se Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*), është specie e rrezikuar dhe duhet që të merret në mbrojtje. Shpendët dhe gjitarët, janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit tonë. Në ekosistemet pyjore të territorit të bashkisë Vau-Dejë, rriten dhe strehohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë. Në kafshët më të rralla dhe që janë me statusin e llojeve të keqësuar apo në rrezik zhdukjeje mund të përmenden: Derri i egër (*Sus scrofa*) dhe Macja e egër (*Felis silvestris*). Por përveç këtyre, takohen edhe gjitarë të mëdhenj si: Ujku (*Canis lupus*), Çakalli (*Canis aureus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes faina* Elxl.), Zardafi (*Martes martes* L.), Baldosa (*Meles meles*), Qelbësi (*Mustela putorius* L.), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri i egër (*Lepus Capensis*), Nuselala (*Mustela nivalis*), Lundërza (*Lutra lutra*), Rriqebulli (*Lynx*), etj. Ndërsa në llojet e rralla të shpendëve që kanë këto statuse dhe që hasen në pyjet e rajonit tonë janë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*), Kumuria (*Streptopelia decaocto*), Skifteri (*Accipiter nisus*), Gakthi (*Botaurus stelleri*), Shkaba (*Gyps fulvus*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Huta me kalca (*Buteo lagopus*). Gjithashtu, takohen dhe një sërë zvarranikësh, ku për vlera të veçanta përmendim, nepërkën me brirë (*Vipera amodytes*), Bolla leopard (*Eiapha situla*), etj

4.7 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, ndodhen disa monumente të natyrës të cilët kanë një rëndësi të veçantë për vlerat e tyre historike, shkencore, estetike dhe turistike. Sipas klasifikimit të IUCN, këto monumente bëjnë pjesë në kategorinë e III të zonave të mbrojtura. Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i karakteristikave kryesore të tyre. Fusha e Liqethit Ndodhet në kreshtën e malit të Cukalit, 1.200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Lekgegaj, Njësia Administrative Shllak e rrethit të Shkodrës. Përbën një grupë glaciokarstike, të formuar në kryqëzimin e shkëputjeve tektonike dhe të modeluar nga karsti. Është e gjatë 1.3 km, e gjerë deri në 1.000 m. Ka formën e një erashke, me disa forma më të vogla karstike. Në fundin e saj ka çakullime e bimësi barishtore dhe formohet një liqen i vogël gjatë shkrirjes së borës. Ka vlera shkencore (gjeomorfologjike), didaktike dhe turistike. Vizitohet duke ndjekur rrugën rurale qyteti i Shkodrës – Cukal. Fragment i thyerjes tektonike Shkodër - Pejë Është ndër thyerjet më të mëdha tektonike në truallin shqiptar, që përshkon territorin nga Shkodra në perëndim deri në Pejë (Kosovë) në lindje. Përgjatë saj bëhet kontakti verior tektonik i shkëmbinjve ofiolitikë të zonës tektonike “Mirdita” me flishin e paleogenit (Pg 1-2) të zonës tjetër tektonike të “Krastë – Cukalit”. Për shkak të riaktivizimit të saj, rigjenerohen shpesh tërmete të fuqishëm. Në planin tektonik ka shumë vizime horizontale, të cilat janë rezultat i shtytjeve të djathta të thyerjes Shkodër – Pejë. Shprehja më e qartë e kësaj thyerjeje është në fshatin Karmë të Pukës. Ai është një monument gjeologjik (gjeomonument) me vlera të mëdha shkencore, gjeologjike e gjeomorfologjike. Vizitohet duke ndjekur rrugën automobilistike Vau-Dejës – Koman. Shpella e Malagjisë Ndodhet në afërsi të fshatit Malagji të rrethit të Shkodrës, në faqen verilindore të malit të Cukalit; në lartësinë 1.300 m mbi nivelin e detit. Është 180 m e gjatë, përbëhet nga disa galeri, që ndërthuren me hapësira më të gjera dhe puse të shumta dhe mjaft të thellë; ka liqene të vegjël dhe konkrecione të shumta. Gjendja e saj është mjaft mirë e ruajtur, por rrezikohet nga banorët vendas dhe pseudospeleologët e huaj. Ka vlera shkencore, didaktike dhe turistike. Për të vajtur tek kjo shpellë, duhet të merret rruga automobilistike Shkodër - Cukal dhe pastaj të vazhdohet më këmbë në drejtim të shpatit verilindor të Cukalit.

4.8 Kushtet Hidrogeologjike

Hidrografia e rajonit përbëhet prej ujërave sipërfaqësorë dhe ujërave nëntokësorë që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Rrjeti hidrografik kryesor i rajonit përbëhet nga baseni I lumit Drin. Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor për lumin Drin, është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në dy stacione: Topojan dhe Bahçallëk. Stacioni i Topojanit jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujit të Drinit të bashkuar: Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, ndërsa monitorimi i stacionit në Bahçallëk jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujërave para derdhjes në detin Adriatik. Në mënyrë periodike kryhet kampionizimi i ujit dhe kryerja e 8 analizave kimike në dy periudha të vitit: prill dhe tetor. Temperatura e ujit për lumin Drin varion 23.2 – 24.1 ° C në fazën e parë (muaji prill) deri në 16.4 °C në fazën e dytë të monitorimit në muajin tetor. pH i ujit për lumin Drin varion nga 7.74 – 8.56 respektivisht për stacionet në Urën e Topojanit dhe Bahçallëk. Ndryshimet stinore nuk e kalojnë vlerën 1.0 (0.15, 0.37 dhe 0.82). Sipas vlerave limite të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), normës për mjedis ujor acid dhe alkaline, ujërat

e lumit Drin kanë gjendje të mirë. Ata janë neutrale ($\text{pH} = 6.5 - 9.0$). Alkaliniteti - Nga matjet e kryera gjatë periudhës vjetore, vërehet se vlerat luhaten nga 123 -140 mol/l në fazën e parë dhe 128 - 143 mol/l në fazën e dytë sipas stacioneve, respektivisht Ura e Bahçallëkut dhe Ura e Topojanit. Luhatjet stinore janë të ulta, nga 0 – 5 mol/l. Rritja e alkalinitetit në fazën e dytë shoqërohet me rritjen e pH dhe të lëndëve të tretura në ujë. Përcjellshmëria elektrike - Luhatet në vlerat 277 - 285 $\mu\text{S/cm}$ respektivisht Ura e Bahçallëkut dhe Ura e Topojanit. Luhatjet stinore janë të ulta 2 – 7 - 9 e deri 49 $\mu\text{S/cm}$ në urën e Topojanit. Në normat europiane nuk jepen kufij të cilësisë së ujërave për përcjellshmërinë elektrike. Megjithatë shihet se vlerat e marra në këtë fazë janë të ulta. Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Drin varion në vlerat 7.33 – 8.86 mg/l. Luhatjet sezonale të oksigjenit janë të ulëta, rreth 0.8 mg/l. Uljet e përmbajtjes së oksigjenit në fazën e dytë lidhen me shkarkimet e mbetjeve si dhe pikën kritike në prurjet e lumit. Lumi klasifikohet në gjendje shumë të mirë për nivelet e oksigjenit. Vlerat e përmbajtjes së NKO_5 kanë luhatje të vogla si dhe vlera të ulëta nga 0.59 në 1.02 mg/l për stacionet e lumit Drin, duke u klasifikuar në gjendje shumë të mirë, ku $\text{NKO}_5 \leq 2$ mg/l. Vihet re një rritje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve, prurjeve si dhe me shkarkimet maksimale si pasojë e turizmit në periudhën e verës. Vlerat e përmbajtjes të nevojës kimike për oksigjen NKO luhatet në 0.44 - 0.8 mg/l në fazën e parë dhe 0.8 – 0.36 mg/l për fazën e dytë. Luhatjet sezonale janë të lehta. Përmbajtja e fosforit total luhatet në vlerat 0.02 – 0.19 mg/l, duke u klasifikuar në gjendje shumë të mirë, ku $\text{Pt} < 0.1$ mg/l. Amoniakut është tregues i ndotjes bakteriale të ujërave. Në stacionet e lumit Drin, gjatë monitorimit të vitit 2015, në fazën e parë nuk është takuar prania e amoniakut në ndryshim nga faza e dytë ku përqendrimi i amoniakut luhatet në vlerat 0.03 – 0.05 mg/l, si pasojë e ndikimit të shkarkimeve të ndryshme. Stacionet paraqesin të njëjtën ecure nga faza në fazë me tendencë rritje pasi dhe periudha e marrjes së kampioneve, ka përkuar me minimumin e periudhës ujëpakët. Sipas standardit për ujërat e ëmbla, ujërat e lumit Drin klasifikohen si të cilësisë shumë të mirë. Vlerat e përmbajtjes së nitrateve luhaten nga 0.3 - 0.8 - 2.0 mg/l për stacionet e lumit Drin. Ujërat e lumit Drin janë të gjendjes së mirë deri në të moderuar. Lumi Drini është nën ndikimin e shkarkimeve urbane të qytetit të Shkodrës dhe zonave përreth. Vlerat e përmbajtjes së nitriteve luhaten nga 0 - 0.02 - 0.05 mg/l. Sipas vlerave limite të përcaktuara nga DKU, ujërat e lumit Drin i përkasin gjendjes shumë të mirë. Lëndët pezull kanë luhatje të vogla si dhe vlera të ulëta nga 1.4 në 10.8 mg/l për të dy stacionet e lumit Drin. Luhatjet sezonale janë relativisht të ulta. Vihet re një ulje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve.

4.9 Klima

Ne Vaun e Dejes , vera eshte kryesisht e shkurter e nxehte dhe pa re, ndersa dimrat jane shume te ftohte , te lagesht dhe pjesisht me re.

Gjate vitit temperature mesatare varion nga 1°C deri ne 32°C dhe ne raste shume te rralla eshte nen -4°C ose mbi 36°C.

Reshjet jane kryesisht ne formen e shiut. Reshjet e debores jane te rralla dhe te kufizuara ne periudha te shkurtra (maks. 2 - 5 dite gjate vitit).


Te dhenat e meposhtme jane te siguruar nga uebsajti : weatherspark.com.

4.10 Regjimi i rrezatimit

Gjatesia e dites ne Vaun e Dejes ka lekundje te medha gjate periudhave te ndryshme te vitit.

Gjate vitit 2023 dita me e shkurter eshte parashikuar te jete data 22 Dhjetor me nje gjatesi prej 9 oresh e 7 minuta dite, nderkohe qe dita me e gjate ka qene me 21 Qershor me 15 ore e 15 minuta dite.

Ne grafikun e meposhtem paraqiten te dhenat e mesiperme. Vija e zeze perfaqeson numrin e oreve kur dielli eshte i dukshem, ndersa ngjyrat nga poshte lart perfaqsojne ditën e plote (ngjyra e verdhe), muzgun (pjesa e ndermjetme mbi vijen e zeze) si dhe naten e plote.(ngjyra gri).




Gjithashtu te dhenat mesatare mujore te oreve me drite paraqiten te permbledhura dhe ne tabelen e meposhtme:

Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Oret me drite	9.5h	10.6h	12.0h	13.4h	14.6h	15.2h	14.9h	13.8h	12.4h	11.0h	9.8h	9.2h

Lindja me e shpejte e diellit eshte ne oren 05:05 me date 15 Qershor nderkohe qe lindja me e vone eshte 2 ore e 4 minuta me vone me daten 4 Janar ne oren 07:09. Perendimi me i shpejte eshte ne daten 9 Dhjetor ne oren 16:09, ndersa perendimi me i vone eshte 4 ore e 11 minuta me vone me daten 27 Qershor ne oren 20:21.

Keto te dhena te permendura paraqiten dhe ne grafikun e meposhtem i cili jep dhe datat e ndryshimit te ores (pra zgjatjen e dites sic e quajme).




4.11 Temperatura e ajrit

Sezoni i nxehte zgjat per 2.9 muaj nga data 14 Qershor deri me daten 10 Shtator me nje temperature mesatare maksimale mbi 28°C. Muaji me i nxehte ne Vaun e Dejes eshte Korriku me nje temperature mesatare maksimale prej 31°C dhe nje temperature mesatare minimale prej 20°C.

Sezoni i ftohte zgjat per 3.6 muaj nga 22 Nentori deri me 11 Mars me nje temperature mesatare maksimale nen 14°C. Muaji me i ftohte i vitit eshte muaji Janar me nje mesatare minimale 1°C dhe nje temperature mesatare maksimale 10°C.

Me poshte keto te dhena paraqiten ne menyre grafike dhe tabelare.Me vije te kuqe tregohet temperatura mesatare maksimale, me vijen blu temperatura mesatare minimale dhe me pika tregohen perkatesisht temperaturat ashtu sic ndihen apo perceptohen nga njeriu.



4.12 Lagështira relative mesatare e ajrit në %.

Llogaritja e lageshtires bazohet ne te ashtuquajturen “piken e veses” apo piken e shkrirjes.

Kur pika e shkrirjes eshte e ulet, ajri ndihet me i thate, ndersa kur pika e shkrirjes eshte me e larte, ajri ndihet me i lagesht. Ndryshe nga temperature e cila mund te pesoje ndryshime drastike midis dites dhe nates, pika e shkrirjes ka tendencen te levize ne menyre me te ngadalte, prandaj nese temperature psh ulet gjate nates, nje dite me ajer me lageshtire shoqerohet zakonisht nga nje nate po me ajer me lageshtire.


Vau i Dejes perjeton disa variacione sezonale persa i perket lageshtires sic perceptohet nga njeriu.

Periudha me lageshtire zgjat 3.8 muaj nga data 1 Qershor deri me 27 Shtator, gjate te ciles ajri ndihet mbytes, apo me zagushi te pakten ne 6% te kesaj periudhe.

Muaji me me shume dite te lageshta ne Vaun e Dejes eshte Korriku me 6.1 dite ose me shume ,te cilat jane me lageshtire.

Periudha me ajrin me te thate gjate vitit eshte data 23 Shkurt kur praktikisht kushtet e ajrit me lageshtire, pothuajse nuk ekzistojne.

Me poshte paraqiten grafiksht dhe ne menyre tabelare te dhenat e permendura me siper :



4.13 Reshjet atmosferike

Nje dite e lagesht konsiderohet kur ka te pakten 1 mm reshje. Mundesite e diteve me reshje ne Vaun e Dejes variojne sipas stineve.

Sezoni i reshjeve zgjat 7.8 muaj nga 19 Shtatori deri me 12 Maj me nje mundesi me te madhe se 24% qe nje dite te jete me reshje. Muaji me ditet me te shumta me reshje eshte Nentori me nje mesatare prej 10.3 ditesh me te pakten 1 mm reshje.

Sezoni i thate zgjat 4.2 muaj nga Maji deri me 19 Shtator. Muaji me ditet me te pakta me reshje eshte Korriku me nje mesatare 3.6 dite me te pakten 1 mm reshje.

Ndermjet diteve me reshje vecohen ditet ne te cilat kemi vetem reshje shiu, vetem reshje debore, apo ditet ne te cilat kemi dhe reshje shiu dhe reshje debore. Muaji me me shume dite me reshje shiu eshte Nentori me nje mesatare 10.3 dite. Bazuar ne kete kategorizim forma me e shpeshte e reshjeve ne Vaun e Dejes eshte vetem shiu me nje mesatare maksimale te perqindjes se renies prej 37% ne daten 21 Nentor.

Me poshte paraqiten te dhenat ne menyre grafike te mundesive te renies se reshjeve dhe te permbledhura ne tabelle.

“SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDSHME KOSMAC”



Ditet me	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Shi	8.7d	8.7d	8.7d	9.0d	7.3d	5.3d	3.6d	4.2d	7.0d	9.1d	10.3d	10.2d
Shi+Debore	0.5d	0.4d	0.1d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.0d	0.3d
Shi ose Debore	9.2d	9.2d	8.8d	9.0d	7.3d	5.3d	3.6d	4.2d	7.0d	9.1d	10.3d	10.5d

Ditet me shi


Per te treguar levizjet Brenda nje muaji dhe jo vetem totalet mujore , llogaritja eshte kryer brenda nje 31-ditori te levizshem te perqendruar rreth cdo dite te vitit.

Vau i Dejes ka ndryshime ekstreme sezonale te reshjeve mujore.

Reshjet e shiut bien gjate gjithë vitit ne Vaun e Dejes. Muaji me me shume shi eshte nentori me nje mesatare pre 133 milimetrash.

Muaji me me pak shi eshte Korriku me nje mesatare prej 22 mm shi.

Me poshte paraqiten grafikisht dhe te permbladhura te dhenat e mesiperme per cdo muaj te vitit.



Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Sasia e Shiut	98.6mm	102.8mm	87.6mm	85.1mm	55.6mm	39.3mm	21.9mm	33.0mm	79.9mm	105.4mm	133.1mm	118.7mm

4.14 Era


Ne kete pjese diskutohet mesatarja orare e vektorit tee res (shpejtesia dhe drejtimi) ne nje lartesi 10 m mbi nivelin e tokes. Era e perceptuar ne cdo lokacion gjeografik eshte shume e varur nga disa faktore sic jane, topografia, bimesia etj, prandaj ne nje moment te caktuar shpejtesite e eres kane diapason levizjeje me te gjere sesa mesataret orare te matura.

Shpejtesia mesatare orare e eres ne Vaun e Dejes peson ndryshime te medha gjate vitit ne varesi te stineve.

Pjesa me erera me te shumta e vitit zgjat 5.2 muaj nga 18 Tetori deri me 25 Mars me nje mesatare me te madhe se 3.3 m/s. Muaji me me shume ere ne Vaun e Dejes eshte muaji Shkurt me nje shpejtesi mesatare orare tee res qe arrin 4 m/s.

Periudha me e qete pa erera zgjat 6.8 muaj nga data 25 Mars deri me 18 Tetor.

Muaji me i qete ne aspektin e ererave eshte Qershori, me nje shpejtesi mesatare orare prej 2.6 m/s.



Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Shpejtesia e Eres(m/s)	4	4	3.6	3	2.6	2.6	2.7	2.7	2.9	3.3	3.7	4

Te dhena te permbledhura per cdo muaj jane dhene ne grafikun dhe tabelen e mesiperme, aty ku vihen re luhatjet e shpejtesive mesatare pergjate muajve.

4.15 Ngjarjet e pazakonta klimaterike

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Zona jonë si pjesë e një rajoni siç është Shqipëria, me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një

regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonshme si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura.

Rajoni i studiuar karakterizohet nga një sasi jo e vogël reshjesh, rreth 1200-1300mm në vit. Të shpërndara si vijon: në dimër rreth 420mm, në pranverë rreth 340mm, në verë rreth 150mm dhe në vjeshtë rreth 360mm. Në vitet e ardhshme (sipas UNEP, 1994) pritet që deri në vitin 2100, si rezultat i ngrohjes globale, të ndodhë një ndryshim i temperaturës mesatare vjetore me 0,7-2,5°C, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në ciklin hidrologjik.

Gjatë dimrit pritet që rritja e temperaturës të ndjekë ecurinë vjetore, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet deri me 5%. Gjatë pranverës temperaturat mesatare që ndryshojnë mes 13,8 dhe 15,7°C mendohet të ndryshojë në 15,2°C dhe 18,5°C, ndërsa sasia e reshjeve do të rritet me 0,18%. Gjatë verës temperaturat mesatare do të luhaten nga 23,2°C në 24,7°C, ndërsa sasia e reshjeve do të zvogëlohet me 60%. Gjatë vjeshtës ndryshimi i temperaturës pritet të jetë më i madh se ai vjetor, për shkak të verës së zgjatur, ndërkohë që sasia e reshjeve pritet të rritet me 53%.

5. VLERËSIME TË NDIKIMEVE NË MJEDIS

5.1 Ndikimet ne terren dhe peisazh

Terreni dhe impaktet vizuale do të theksohen me shumë gjatë fazës së ndërtimit dhe në një kohë të shkurtër kështu që shërbimet nuk janë shumë të nevojshme apo janë të limituara në përdorimin e tyre. Pronat e afërta janë mjaft larg nga projekti. Interferencat e projektit me kontekstin vizual të tyre do të mbetet e ulët. Godinat e trashëgimisë janë gjithashtu mjaft larg rrugës kështu që konteksti vizual i tyre nuk do të ndryshohet shumë nga projekti.

Impakti i përgjithshëm nga afatshkurter deri në afatmesëm në projektin e propozuar të karakterit të terrenit është konsideruar të jetë në nivelin e ulët.

Këto procese nuk do të ndikojnë negativisht në tokë, kjo vjen si rezultat se nuk do të magazinohen lëndë të rrezikshme. Erozioni i tokës: Nisur nga nivelet e punimeve nuk parashikohet që të ketë ndikime të aspekteve të erozionit. Për të eliminuar dhe minimizuar ku është e mundur këto ndikime nga ana sasiore, subjekti ka hartuar një plan menaxhimi, i cili merr në analizë të gjithë skenarët e mundshëm që mund të kenë pasoje negative në mjedis. Efekti më i rëndësishëm në tokë është zënia e tokës së lirë me ndërtim të përhershëm dhe humbja e hapësirave të lira.

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo

Ndryshimi i relievit te tokes		x		x
Ndotja e tokës nga rrjedhjet		x		x
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta	x			x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave	x			x

5.2 Dherat dhe Ri-shfrytezimi i materialeve të gërmuara

Materialet e gërmuara që janë të menduara për rishfrytezim do të menaxhohen dhe trafikohen në minimum dhe do të depozitohen në një mënyrë që të minimizohet efekti i motit. Koha ndërmjet gërmimit dhe rishfrytezimit gjatë periudhës do të thahet në një minimum. Gjatë periudhës të zgjatura të thatësirës kontraktori do të ndalojë gërmimet dhe do vendosë këto materialet për të parandaluar degradimin për shkak të thatësirës.

Ndikimi gjatë Fazës së Funkcionimit dhe Masat Lehtësuese

Në përfundimin e ndërtimit do të kryhen inspektime vizuale në të gjithë strukturat e projektit, për të siguruar se nuk shkaktojnë erozion, dhe që të identifikojnë kërkesat për kryerjen e çdo punimi riparues. Kjo mund të ulë impaktin e mundshëm në të ardhmen për humbjen e dherave dhe impaktet që lidhen me terrenin të shkakтуara nga erozioni.

5.3 Ndikimi në nivelin e zhurmave

Emetimet e zhurmës nga vendet e ndërtimit do të ndikohen edhe nga përdorimi i makinerive të mëdha që mund të provokojnë bezdi dhe zhurma si psh, venia e shtyllave etj. Zhurma mund të krijohet nga shumë veprime ndërtimi dhe varet nga faktorë si: lloji i pajisjes, veprimet që do të kryhen dhe makineritë që do të përdoren-kushtet e makinerive dhe makinat e përdorura. Leq (niveli ekuivalent) për disa faza ndërtimi varet edhe nga gjatësia e kohës që aparti është në veprim. Lloji dominues i zhurmës për shumicën e pajisjeve të ndërtimeve është motorri, zakonisht me naftë dhe pa silenciator. Në pak raste si psh për një shofer-grumbullimi apo një vegëlthyese pneumatike betoni, dominon zhurma e shkakтуar nga kryerja e veprimit.

5.4 Ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Në këtë projekt nuk parashikohet të ketë ndikime në rrjetin ekzistues të furnizimit me ujë të pijshëm apo rrjetin e kanalizimeve. Në rast se punimet zbatohen në mënyrë korrekte, pa shkakтуar aksidente në infrastrukturen ekzistuese. Nuk kemi ndotje të ujërave nëntokësore. Ujërat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të objektit janë ujëra të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagës së kantierit, largës së gomave të automjeteve dhe ujërat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Një faktor tjetër mund të jenë ujërat e pastrimit e të largës së kazanëve të betonierëve gjatë shkarkimit të betonit në kantier. Këto të fundit, nuk duhet të shkarkojnë ujërat në çdo mjedis rrethor, ato duhet të shkarkohen në mjedise të caktuara dhe në kantieret e prodhimit të betonit. Gjatë ndërtimit, në varësi edhe të rreshjeve të shiut, mund të grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujërave dhe si rrjedhojë mund të jetë i nevojshëm grumbullimi i këtyre ujërave dhe orientimi i tyre në sistemin e kanalizimeve, pjesërisht ato filtrojnë nëntokë. Në

kantier nuk do të magazinohen materiale të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujërave nëntokësore ose sipërfaqësore. Si rrjedhojë, punimet e ndërtimit nuk duhet të tejzgjaten dhe të kalojnë afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit.

Lloji i ndikimit në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujrave të ndotur	x			x
Ndotja e ujit prej pluhurit, plumbit, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera		x		x
Ujërat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të objektit	x			x
Impakti sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore etj.	x			x
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore	x			x
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore		x		x

5.5 Emëtimet në ajër

Emëtimet në ajër do të vijnë nga përhapja e pluhurave të materialeve të ndërtimit dhe materialit të gërmuar të sipërfaqes së tokës. Përdorimi i rërës, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve përreth, si dhe nga transporti i automjeteve të dheut të gërmuar jashtë ambjenteve të kantierit të punës. Gjithashtu djegia e lëndës djegëse, që do të vijë vetëm nga automjetet që do të frekuentojnë këtë ambient, si dhe në raste të rralla kur ka mungesë të energjisë elektrike dhe do të lindë nevoja për ndezjen e gjeneratorit. Pra mund të themi se niveli i shkarkimeve do të jetë i ulët, kjo vjen si rezultat i mjetet rrugore që qarkullojnë janë konform normave të përcaktuara dhe të testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik të automjeteve. Nga punimet ndertuese do të ketë përhapje të pluhurave nga qarkullimi i mjeteve. Përdorimi i rërës, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve përreth, si dhe nga transporti i automjeteve të dheut të gërmuar jashtë ambjenteve të kantierit të punës.

Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Prodhim i pluhurit	x			x
Djegia e lëndës djegëse nga automjetet	x			x

5.6 Ndikimi në nivelin e zhurmës

Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga përdorimi i vincave të

ndryshëm, gjeneratorëve, zhurma e prodhuar nga vete personat që do të punojnë për këtë kantier, proceset e hedhjes së betonit, përdorimi i skelave dhe dërrasave, pajisjeve të prerjes së hekurit, etj.

Punëtorët që mund të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e dëgjimit. Kjo duhet të kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve. Nuk do të shkaktohen vibrime shqetësuese gjatë punimeve.

Për të reduktuar këtë ndikim tek banesat pranë, subjekti ndërtues, nuk duhet të punojë gjatë orëve të vona ku niveli i lejuar i zhurmave është më i ulët dhe foni i rrugës apo aktiviteteve të tjera është me i ulët.

Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave		x		x
Vibrime shqetësuese gjatë punimeve		x		x
Rritja e nivelit të zhurmave nga aktivitetit, makinave	x			x
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit	x			x

5.7 Mbetjet

Gjatë ndërtimit do të krijohen mbetje inerte të cilat do të dalin si pasojë e largimit të dherave të gërmimit për themele, ambalazhe të materialeve të ndërtimit, etj.

Shumica e këtyre materialeve janë të riciklueshme dhe do të ripërdoren për nevoja të këtij ndërtimi, apo të banorëve. Mbetje të ngurta që prodhohen nga ndërtimi në këtë zonë janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letrë, metale, mbetje organike, materiale inerte të prodhuara nga punimet ndërtuese, si dhe dheu e mbetjet inerte që do të largohen nga sheshi i ndërtimit. Mbetje inerte si rërs, zhavorri, dheu nga germimet, proceset e betonimit mund të përdoren për shtrimie të sipërfaqeve përreth ose materialet të cilat janë të ripërdorshme, mund t`ju jepen individëve të interesuar për punime ndërtimi në zonat afër ndërtimit ose rehabilitim të lulishteve ose mbushje të tokave aty ku ka nevoje, pjesa e mbetjeve të pa përdorshme duhet të grumbullohen në vendin e caktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore(NJ.Q.V) pas zbardhjes së Lejes së Zhvillimit nga autoritetet përgjegjëse.

6. MASAT KRYESORE LEHTËSUESE

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga kontratuesit për zbatimin e projektit. Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmblendhur si më poshtë shënuar.

- Lagia e shesheve të pa shtruara gjatë punimeve të ndërtimit dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri për të minimizuar ngritjen e grimcave të ngurta (pluhurave) në ajër.
- Mbetjet e ngurta urbane që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Bashkia.
- Duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundshme për të siguruar që ambjenti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.
- Sistemi i shkarkimit të ujërave urbane të jetë i lidhur me sistemin e kanalizimeve të zonës.
- Përdorimi i materialeve termoizoluese në ambjentet e magazinimit.
- Të sistemohet dhe rehabilitohen sheshet e lira dhe lulishtet e objektit pas përfundimit të punimeve të objektit.
- Të respektohen oraret e qetësisë publike dhe të mos punohet në orët e vona.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.

Cështja	Masat	Periudha
Pluhuri	Është e nevojshme që zhvilluesi të kryejë vëzhgime vizuale të ngritjes së pluhurit gjatë gjithë fazës ndërtimore. Të gjitha aktivitetet, para fillimit të tyre, duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi për mundësinë e ngritjes së pluhurit. Është me rëndësishëm vëzhgimi i kushteve të motit.	Gjatë gjithë fazës së ndërtimit
Mbetjet	Vëzhgime vizuale të zonave të ruajtjes,	Inspektime mujore. Marrja e masave parandaluese dhe

	grumbullimit dhe largimit të mbeturinave. Largimi i mbetjeve më periudha konstante. Përdorin masat e duhura të sigurisë gjatë mbartjes dhe transportimit të mbeturinave, dhe i hedhin në vendet e autorizuara me aprovimin e autoriteteve lokale.	korrigjuese, në se është e nevojshme. Gjatë gjithë fazës së ndërtimit
Mbetjet e lëngshme	Sigurimi së mbetjet e kanalizimeve të ujërave të ndotura, janë menaxhuar në mënyren e duhur, bazuar në kuadrin ligjor për këtë qëllim.	Vazhdimisht gjatë gjithë fazës së ndërtimit
Transporti i materialeve	Punonjësve të kamionëve do t’u kërkohet të mbulojnë ose të lagin ngarkesat e kamionëve, tërheqin materialet jo në orët e kulmit të trafikut, dhe të përdorin rrugë alternative për të minimizuar ngjeshjen e trafikut.	Gjatë gjithë fazës së ndërtimit
Zhurma	Është e nevojshme që nuk duhet të punohet gjatë orëve të vona ku niveli i lejuar i zhurmave është më i ulët.	Gjatë gjithë fazës së ndërtimit
Monitorim i vazhdueshëm i parametrave mjedisore (Clirimet në ajër, shkarkimet në ujë dhe në tokë)	Pajisjet e monitorimit dhe metodat do të jenë në përputhje me kërkesat kombëtare shqiptare për këtë aktivitet sipas VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për monitorimet” dhe në	Gjatë gjithë fazës së ndërtimit

	kushtet e vëna në lejen mjedisore	
--	-----------------------------------	--

7. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Përfundimi më i rëndësishëm është se projekti nuk ka ndikim negativ të rëndësishme dhe afatëgjata në mjedis,
- Gjatë aktivitetit të ndërtimit të godinës dhe gjatë funksionimit të saj nuk do të shkatohet ndotje e tokës, ajrit, ujit.
- Të zbatohet projekti i ndërtimit dhe përdorimi i fasadave cilësore për të krijuar një pamje estetike.
- Leja e ndërtimit me të dhënat urbanistike të përcaktuara në projektin e paraqitur.
- Pas çdo punimi remonti apo shërbimi teknik të bëhen akte përkatëse dhe të regjistrohen këto punime. Herë pas here do të kryhen:
 1. Matje të përqendrimit në ajër e tokë të ndotësve;
 2. Kontrolli sanitar i personelit;
 3. Identifikim i impakteve në mjedis, që do të jenë të vazhdueshme dhe të detyrueshme.
- Pastrimin (mirëmbajtjen) e gjithë sheshit të ndërtimit dhe rrethimit të tij për moslejimin e hyrjes së individëve apo shkaktareve të ndryshme të ndotjeve, dentimeve, zjarreve në objektin në ndërtim si dhe në mjediset përreth objektit.
- Të kryhet lagia e sipërfaqeve të gërmuara, atyre me inerte dhe të rrugëve komunikuese gjatë sezonit të thatë.
- Të kryhet rrethimi i kantierit të ndërtimit gjatë punimeve ndërtuese dhe të vendosen postera paralajmërues për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të kryhet larja e automjeteve para daljes së tyre në rrugët e asfaltuara të zonës.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të renduar në zonë.
- Të menaxhohet dheu i gërmuar për hapjen e themeleve, duke u sistemuar në një vend të caktuar nga Bashkia.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të VNM.
- Subjekti ndërtues të respektojë dhe zbatojë ndërtimin e infrastrukturës teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të ndërtohen shkallët e emergjencës.

- Me marrjen e masave në favor të mbrojtjes së mjedisit edhe ato pak elemente që mund të kenë një ndikim të vogël negativ në mjedis dhe që janë përmendur me lart mund të kapërcehen.
- Projektimi i hapësirave të nevojshme dhe i sipërfaqeve të gjelbra do ti japë një pamje tërheqëse dhe funksionale zonës.
- Aktiviteti do të paraqesë një ndikim minimal në mjedis dhe me zbatimin e masave parandaluese veçanërisht gjatë fazës ndërtimore do të ketë ndikime pothuajse minimale,
- Mbajtja pastër e mjediseve të zonës së banimit do të jetë dhe do të bëhet në vazhdimësi për të garantuar një mjedis të kultuar dhe të pastër brenda godinës.
- Si përfundim ndikimet do të jenë pozitive nga ndërtimi në një kohë të shpejtë duke marrë parasysh edhe kriteret e duhura për zhvillimin urbanistik të zonës dhe ato për mbrojtjen e mjedisit.

Si përfundim mund të themi se efektet e ndërtimit të **objektit “SISTEMIM, ASFALTIM RRUGET E BRENDASHME MELGUSHE”, në Bashkinë Vau Dejes**, do të jetë pozitive duke patur parasysh edhe kriteret e duhura për mbrojtjen e mjedisit.

Analizat e mësipërme nuk nxjerrin në pah ndonjë impakt negativ ose ndikim mbi ujë nëntokësor/akuiferët dhe mbi ndonjë prej instalimeve që lidhen me furnizimin e ujit të vendbanimeve.

Gjatë zbatimit të projektit duhet të merren në konsideratë të gjitha opinionet e dhëna në këtë studim në lidhje me masat monitoruese që duhet të ndërmerren gjatë zbatimit të punimeve.

***PUNOI: Ing. Nikoll Paluca
Ing. Gabriela Paluca***